



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

Up1 nr. 11-297

10.06. 2021 Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19), dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 i të njëjtit ligj, pika 8 e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i konsoliduar) ark.nr.016039 / 1 i datës 20.10.2015 dhe Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr. 112260/1 me 07.06.2021, përshkak të kostatimit të mosrespektimit të dispozitave nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, gjegjësisht përshkak të riemimit të serviseve programore në kundërshtim me nenin 141 i të njëjtit Ligj, nga ana e Shoqërisë për tregti, prodhimtari dhe shërbime ANTENA AS KTV eksport-import SHPKNJP Kërçovë, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 17-të të mbajtur me datë 09.06.2021, në përputhje me Konkluzionin ark. Nr. 02-2249/9 me 10.06.2021, e miratoi si në vijim:

Vendim

për vërejtje publike dhe për çkyçjen e riemimit të serviseve programore

1. **PUBLIKISHT PARALJMËROHET** Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime ANTENA AS KTV eksport-import SHPKNJP Kërçovë, sepse ka rreemeluar shërbime programore që nuk janë të regjistruara në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në përputhje me nenin 141 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e cila dënohet sipas nenit 148 paragrafi 1 pika 25 dhe paragrafi 2 i të njëjtit ligj.
Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore nr.11-2260 / 1 me 07.06.2021, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojcë nr.1.
2. **I URDHËROHET** Shoqërisë për tregti, prodhim dhe shërbime ANTENA AS KTV eksport-import SHPKNJP Kërçovë, menjëherë pas marrjes së këtij vendimi që të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në mënyrë që do të përjashtojë rreemetimin të serviseve programore.
3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolluese, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi, ka vepruar sipas vendimit për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e rreemetimit shërbimeve programore.
4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij vendimi nuk vepron sipas vendimit, përkatësisht vazhdon të kryejë shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuel në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente.
5. Ky Vendim është përfundimtar dhe si ditë e miratimit konsiderohet dita e verifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 alineja 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale do të marrë masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ose rregulloret e miratuara në bazë të kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele është kompetente për të kryer mbikëqyrje programor të programeve të emetuesve dhe të dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesës, si dhe të paketave programore të cilat i rritmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, certifikatave të regjistrimit të lëshuara, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, më 04.06.2021, Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të serviseve programore të rritmetuara nga operatori Shoqëria për tregti, prodhim dhe shërbime ANTENA AS KTV eksport-import SHPKNJP Kërçovë, ku ka konstatuar se operatori në fjalë i cili sipas njoftimit nga Agjencia për komunikime elektronike mund të operojë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka rritmetuar servise programore që nuk mbulohen me vërtetimet për regjistrimin e serviseve programore të lëshuara nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, që është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të detajuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr.11-2260/1 me datë 07.06.2021, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi si në vijim nr.1.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 të të njëjtit ligj, pika 8 e udhëzimit për caktimin e afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-6039/1 të datës 20.10.2015 dhe Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore Ark.nr. 11-2260/1 për mos respektimin e dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ka miratuar vendim me të cilin subjektit të mësipërm i shqiptohet vërejtje publike dhe menjëherë pas marrjes së vendimit për çkyçjen e rritmetimit të serviseve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolluese, për të konstatuar nëse subjekti i përmendur ka vepruar sipas urdhrit, përkatësisht vërejtjes publike dhe ka ndërprerë rritmetimin e serviseve programore.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori mund të ngrejë padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Në bazë të asaj që u përmend më sipër, vendimi u miratua së në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi pranë gjykatës kompetente për ngritjen e kontestit administrativ. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Shtojca (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, nr.11-2260 / 1 nga data 07.06.2021.

